

BULETINI INFORMATIV

TETOR

2025



Vendimmarrjet e Bordit të ERE gjatë muajit tetor

Gjatë muajit tetor 2025, Bordi i ERE ka zhvilluar gjashtë mbledhje vendimmarrëse. Në këto mbledhje u shqyrtuan dhe miratuan 19 vendime të cilat të plota mund ti shfletoni të publikuara në faqen zyrtare të ERE-s në kategorinë [vendimet](#).

Licencime të reja

Gjatë muajit tetor janë licencuar në veprimtarinë e furnizimit dhe të tregtimit për një afat 5 vjeçar secila, përkatësisht shoqëritë:

- “REYTECH TRADING” sh.p.k.
- “VIVID POWER” sh.p.k.
- “GREEN VALUE” sh.p.k.
- “GSA ENERGY” sh.p.k.

Procedura licencimi të filluara gjatë muajit tetor

- “GET SOLAR SOLUTION” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaik me kapacitet 24 MW, me vendndodhje në Bashkinë Kolonjë, Qarku Korçë, për një afat 30-vjeçar.
- “PROSOL” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 21MW, vendndodhje në Bashkinë Fier, Qarku Fier, për një afat 30 vjeçar.

Gjithashtu ERE ka filluar procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 98, Datë 16.04.2021.

Për këto vendime janë njoftuar shoqëritë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithashtu në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar. ERE për të gjitha këto aplikime ka publikuar në median e shkruar, në faqen zyrtare www.ere.gov.al si dhe në rrjetet sociale Instagram, Facebook dhe LinkedIn, njoftimin për marrjen e objeksioneve para vendimmarrjes respektive të licencimit ose jo.

Autorizime për garanci financiare

Bordi i ERE-s miratoi kërkesën e shoqërisë “ERSEKA SOLAR PARK 1” sh.p.k., licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet 20 MW, për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes sigurorese) të aseteve fikse të saj.

Bordi i ERE-s miratoi kërkesat e shoqërive “ERSEKA SOLAR PARK 2” sh.p.k. dhe “AGE ERZEN” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të tyre si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.

Si dhe filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k., licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “HEKALI” me kapacitet të instaluar 1940 kW dhe vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë, për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.

Pas çdo vendimmarrjeje është përditësuar regjistri përkatës i autorizimeve dhe është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

BULETINI INFORMATIV

TETOR

2025



Garancitë e origjinës

Garancitë e origjinës të lëshuara nga ERE gjatë vitit 2025, janë në sasinë prej 21,222 MWh, konkretisht të miratuara me Vendimet e Bordit të ERE-s nr. 17/2025 dhe nr. 119/2025. Garancia e Origjinës (GO), është një dokument elektronik, i cili ka funksion të vetëm që t'i provojë konsumatorit fundor se, një pjesë ose e gjithë sasia e energjisë elektrike të përdorur prej tij është prodhuar prej burimeve të rinovueshme. Për më shumë informacion mund të shfletoni rregulloren për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme në linkun: <https://shorturl.at/OvG8F>

Vendime të tjera

Në kuadër të plotësimit nga ana e shoqërive, të kushteve të paravendosura, u rishikuan vendimet të cilat gjenden më poshtë të cituara:

1. “Mbi licencimin e shoqërisë “EB ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW”.
2. “Mbi licencimin e shoqërisë “RENEW” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW”.Për këtë shoqëri u përcaktua gjithashtu data 11.06.2026 si afati i fundit për fillimin e ushtrimit të vepritarisë së prodhimit të energjisë elektrike.
3. “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “RENEW” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Procredit Bank” sh.a.”.
4. “Mbi licencimin e shoqërisë “ALBESP TRADING & CONSULTING” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
5. “Për dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj Banka e Tiranës sh.a., Banka OTP Albania sh.a., Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. dhe Union Bank sh.a.”.

Gjithashtu:

U miratua kërkesa e shoqërisë “MANAGEMENT & DEVELOPMENT ASSOCIATES L.L.C” për njohjen e licencës në veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës (ZRRE), e vlefshme deri në datën 09.07.2030.

U vendos në përputhje me Metodologjinë e energjisë së rinovueshme saktësimi që parashikon se në aplikimin e parë të përcaktimit të detyrimit të energjisë së rinovueshme për **Operatorin e Energjisë së Rinovueshme** (OER) apo çdo entitet tjetër që kryen detyrat e tij, afati i aplikimit do të jetë jo më vonë se 3 muaj përpara hyrjes në fuqi të kushtit të përcaktuar në nenin 4.2 të metodologjisë, ku përcaktohet që energjia e blerë nga OER-ja do të lëvrohet direkt në tregun e organizuar të ditës në avancë dhe/ose brenda të njëjtës ditë.

Regjistri REMIT

Në përputhje me “Rregulloren për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë (REMIT)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 126, datë 17.05.2021 si dhe Ligjin nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, edhe gjatë muajit Shtator ERE ka publikuar të dhënat mbi regjistrimin e Pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike që hyjnë në transaksione me shumicë në Shqipëri (regjistri REMIT). Ky regjistër, gjendet i publikuar dhe i përditësuar në faqen e ERE-s në linkun <https://ere.gov.al/sq/tregu-i-energjisë/remi>. Gjatë kësaj periudhe kohore janë regjistruar tre shoqëri.

BULETINI INFORMATIV

Standardet e Cilësisë së Furnizimit me Energji Elektrike në rrjetin e shpërndarjes dhe transmetimit.

Gjatë muajit tetor 2025, Operatorët OST sh.a. dhe OSSH sh.a., kanë raportuar përmirësime në treguesit e cilësisë së furnizimit me energji elektrike, duke krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Performanca e OST sh.a.

Të dhënat tregojnë përmirësim të konsiderueshëm në disa prej treguesve kryesorë të performancës:

- Koha mesatare e ndërprerjes (AIT) është reduktuar nga 16.17 minuta, në vitin 2024 në 11.49 minuta, në vitin 2025;
- Energjia e pafurnizuar (ENS) ka zbritur nga 236,502 MWh (v.2024) në 166,556 MWh (v.2025); si dhe
- Koha e përgjigjes për lidhje të reja është përmirësuar nga 31 ditë (v.2024) në 22 ditë (v.2025).

Këto të dhëna konfirmojnë rritjen e qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të transmetimit të energjisë.

Performanca e OSSH sh.a.

Duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, OSSH sh.a. ka regjistruar përmirësime në treguesit kryesorë të cilësisë së furnizimit:

- Numri mesatar i ndërprerjeve për konsumator (SAIFI) është ulur nga 19.46 në 16.09.
- Koha mesatare e ndërprerjeve (SAIDI) është reduktuar nga 31.13 orë në 25.89 orë.

Këto rezultate reflektojnë një rritje të qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike për konsumatorët fundorë.

Zhvillime në Tregun e Liberalizuar

Një furnizues i ri, Volton sh.p.k., ka publikuar ofertar e tij në platformën PCT (Price Comparison Tools), në faqen zyrtare të EREs: <https://pct.ere.gov.al/>, duke i mundësuar konsumatorëve të krahasojnë çmimet dhe të zgjedhin furnizuesin që u përshatet më mirë nevojave të tyre. Aktualisht në platformë rezultojnë shtatë shoqëri ofertuese të regjistruara, ofertat e të cilëve janë të ndara sipas niveleve të tensionit të energjisë 10 kV, 20 kV dhe 35 kV.

Të dhënat e tregut të energjisë për vitin 2025

Sasia e energjisë së prodhuar deri në fund të muajit Shtator rezultoi në vlerën 5,065,782 MWh duke shënuar një ulje prej rreth 13.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, ndërsa sasia e energjisë së konsumuar u përlogarit në vlerën 6,136,634 MWh duke rezultuar me një rritje prej rreth 1,6% për të njëjtën periudhë kohore.

Kapacitetit total prodhues të energjisë elektrike të instaluar në vendin tonë gjatë muajit Shtator i është shtuar një central hidrik i pozicionuar në zonën e Gramshit, me kapacitet të instaluar prej 10,8 MW i cili operohet nga shoqëria "H.K HEC Grabova 2" sh.p.k. si dhe një central fotovoltaiik me vendndodhje në zonën e Aeroportit të Kukësit me kapacitet të instaluar prej 12 MW i cili operohet nga shoqëria "GLOBAL TECHNICAL MECHANICS" sh.p.k. Për të njëjtën periudhë korresponduese kanë vijuar të dalin në treg të lirë 2 hidrocentrale të cilët kanë zotëruar kontratë shit-blerje me FTL sh.a me një kapacitet të instaluar prej 1,95 MW duke e rritur kapacitetin total të hece-ve të cilat kanë dal në treg të lirë gjatë vitit 2025 në 28,32 MW.

Përgjatë të njëjtit muaj prurjet në Fierzë shënuan vlerën mesatare 33 m3/sek duke rezultuar në vlerën më të ulët mujore të prodhuar nga kaskada gjatë vitit 2025 e cila regjistroi një vlerë prej 183 GWh. Niveli në liqenin e Fierzës, më 1 Tetor, rezultoi në kuotën 261,89 metra mbi nivelin e detit (mmnd) duke shënuar nivelin më të ulët për këtë vit. Si rrjedhojë, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a. ka vijuar të blejë sërish energji elektrike në tregun e lirë si pasojë e një situatë hidrike jo të favorshme të rreshjeve për të mbuluar nevojat konsumatore në vend. Blerjet në treg të lirë ishin 251,103 MWh energji elektrike me një çmim mesatar prej 115,49 €/MWh duke arritur vlerën e 1,486,438 MWh energji elektrike totale të blerë për 9 mujorin e vitit 2025.

Vlen të theksohet se **për 9 mujorin e vitit 2025 prodhimi nga centralet fotovoltaike** të lidhura në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes u përlogarit 668,056 MWh duke përbërë rreth 13,1% të prodhimit total vendas. Ky tregues reflekton rritjen e ndjeshme të kapaciteve të instaluara fotovoltaike përgjatë viteve të fundit duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në mbulimin e nevojave energjitike të vendit.

Humbjet e përgjithshme të sistemit të shpërndarjes për 9 mujorin e 2025 arrijnë në 16.24%, duke ruajtur trendin ulës me rreth 1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Në sistemin e transmetimit për 9 mujorin e 2025 humbjet mbeten në vlerën 1.90 % me një diferencë prej 0,12% me pak për të njëjtën periudhë korresponduese.

Numri total i Anëtarëve të Bursës të regjistruar për zonën e ofertimit në Shqipëri për 9 mujorin e vitit 2025 është 26. Shoqëritë e reja të cilat janë regjistruar gjatë kësaj periudhe kohore janë 3, përkatësisht "AI EnergyX" sh.p.k, "SPV BLUE 2" sh.p.k dhe "Sunny Side Energy" sh.p.k. Çmimi mesatar ditore klerues për muajin Shtator ka qenë 109.52 €/MWh ndërkohë që volumet mesatare ditore janë përlogaritur rreth 2,957 MWh. Për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë, oferta në blerje për muajin shtator ishte 135,918.00 MWh, ndërsa oferta në shitje 139,582.91 MWh. Për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë, oferta në blerje për muajin shtator ishte 135,918.00 MWh, ndërsa oferta në shitje ka qenë 139,582.91 MWh.

BULETINI INFORMATIV

TETOR

2025

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kW të lidhura në nivelin e tensionit 0.4 kV

Pas shqyrtimit të kërkesës së FSHU sh.a. dhe vlersimeve përkatëse, në mbledhjen e datës 15.10.2025 bordi i ERE-s vendosi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kW të lidhura në nivelin e tensionit 0.4 kV, që do të aplikohet nga data 1 Nëntor 2025.

Kërkesa e depozituar në ERE prej FSHU sh.a., nuk përmban elementët e një aplikim për përcaktimin apo rishikimin e cmimeve të shitjes së energjisë elektrike me pakicë për konsumatorët që shërbehen në kushtet e shërbimit universal të furnizimit, por evidenton në nevojën për kategorizimin e një grupi të ri konsumator dhe përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, përmes të cilit të ardhurat që do të krijohen do të shërbejnë për mbulimin e kostove të disbalancave të shkaktuara nga kjo kategori në periudhën në vazhdim.

Çmimi prej 22 Lekë/kWh do të aplikohet nga data 1 Nëntor 2025 për të gjithë klientët familjarë dhe jofamiljarë, të cilët për qëllime të karikimit të një makine elektrike për përdorim vetjak rezultojnë të kenë apo kërkojnë një shtesë fuqie apo pikë lidhje të re me kapacitet të instaluar mbi 11 kW.

Sa i takon energjisë elektrike e cila konsumohet në pik nga kjo kategori, sikurse aplikohet në kategoritë e tjera konsumatore, çmimi i shitjes së energjisë aktive në pik do të jetë 15% më i lartë se çmimi i shitjes së energjisë aktive.

Ndërkohë që për klientët me fuqi të instaluar deri në 11 kW, FSHU sh.a. do të vijojë të aplikojë çmimet respektive të miratuara nga ERE. Subjektet ruajnë të drejtën e zgjedhjes së mënyrës së furnizimit nga pikat e karikimit, duke mundur të furnizohen me çmimet ekzistuese për fuqinë nën 11 kW ose të përdorin stacionet mbi këtë prag, kundrejt çmimit të miratuar nga bordi i ERE-s. **Aktualisht konsumatorë të cilët përdorin makina elektrike, kanë mundësinë të furnizohen nga FSHU sh.a. me çmimet përkatëse të pandryshuara prej 8.5 Lekë/kWh ose 9.5 Lekë /kWh në varësi të konsumit dhe për konsumatorë jo familjarë me çmimin prej 14 Lekë / kWh.**

Po në kuadër të kësaj vendimmarrje, në vijim **u shqyrtua dhe nuk u pranua kërkesa e Shoqatës “Taksitë e Klasit të Parë” dhe Sindikatës Shqiptare të Taksive për pezullimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025**, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kW”. ERE vlerësoi se për sa i përket kërkesës në lidhje me pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025:

Në zbatim të nenit 133, pika 3, gërma c të Kodit të Procedurave Administrative, pezullimi i një akti administrativ nuk lejohet kur zbatimi i tij është në interes publik. Vendimi nr. 255/2025 ka për qëllim garantimin e funksionimit të qëndrueshëm financiar dhe stabiliteti teknik të furnizimit universal (FSHU) dhe mbulimin e kostove të disbalancave të shkaktuara tashmë në sistem nga përdoruesit e stacioneve të karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kW, në mbrojtje kështu të interesit publik.

Sipas nenit 180 të Kodit të Procedurave Administrative, pezullimi i ekzekutimit mund të vendoset vetëm kur provohet rreziku i një dëmi të rëndë dhe të pazëvendësueshëm për subjektin, pa cenuar interesin publik rrethana që në këtë rast nuk janë provuar nga palët kërkuese.

Zbatimi i vendimit nuk u shkakton dëm të pariparueshëm palëve kërkuese pasi ekzistojnë mekanizma adjustimi në vijim, ndërsa pezullimi i tij do të krijonte pasoja të drejtpërdrejta financiare për konsumatorët e tjerë të shërbimit universal dhe do të cënonte sigurinë e furnizimit. Për rrjedhojë, kërkesa për pezullim të menjëhershëm të zbatimit të vendimit nr. 255/2025 nuk u gjet e bazuar në prova dhe në kuadrin ligjor në fuqi.

Lidhur me sa kërkuar për shfuqizimin e vendimit të sipërcituar ERE do të shprehet në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, legjislationit sektorial në fuqi dhe afateve ligjore të përcaktuara për këtë procedurë.

Lidhur me kërkesën e palëve për krijimin e një mekanizmi subvencioni ose lehtësish fiskale për kategorinë e taksive elektrike, vlerësohet se:

ERE, në ushtrimin e kompetencave të saj, ka detyrimin të garantojë shmangien e ndërsuvencionimit ndërmjet kategorive të konsumatorëve, duke siguruar që çmimet dhe tarifat të mbështeten në koston reale që secila kategori i shkakton sistemit, në përputhje me nenin 19, gërma ë të ligjit nr. 43/2015, Për sektorin e energjisë elektrike, të ndryshuar.

ERE nuk mund të vendosë skema financiare që do të transferonin barrën e kostove nga një kategori konsumatorësh te një tjetër, pasi kjo do të binte ndesh me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit tarifar të përcaktuara në kuadrin ligjor të sektorit të energjisë.

Subvencionet, incentivat ekonomike dhe lehtësitë fiskale për kategori të veçanta përdoruesish janë instrumente të politikave publike që vendosen nga organet kompetente të politikës fiskale dhe të transportit, si Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Për rrjedhojë, kjo çështje nuk përbën objekt vendimmarrjeje të Bordit të ERE-s, ndërkohë që shqetësimet e ngritura nga përdoruesit e taksive elektrike, edhe pse përbëjnë interesa legjitimë publike, janë adresuar për kompetencë pranë institucioneve përkatëse dhe nuk mund të trajtohen përmes rishikimit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025.

BULETINI INFORMATIV

TETOR

2025

Publikime dhe përditësime në webfaqe dhe në rrjetet sociale

Gjatë muajit tetor është përditësuar informacioni në webin e ERE-s dhe rrjetet sociale me vendime, njoftime të mbledhjeve, njoftime mbi aplikime të reja për licencim si dhe çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për vitin 2025.

Gjithashtu, në webfaqen e ERE-s gjenden të rifreskuar regjistrat e mëposhtëm:

- Kërkesa dhe përgjigje në Programin e Transparencës ([kliko këtu](#))
- Ankesa të konsumatorit ([kliko këtu](#))
- Licencime ([kliko këtu](#))
- Autorizime ([kliko këtu](#))

PCT
ALBANIA



www.ere.gov.al



0800 23 23

Çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit

Në mbledhjen e datës 08.10.2025 Bordi i ERE-s miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shtator 2025, në vlerën 14.76 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV. Ky çmim rezulton më i lartë krahasuar me muajin gusht 2025, i cili ishte 14.70 Lekë/kWh, pra ka një rritje prej 0.4% për muajin shtator.

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) është variabël dhe ndryshon nga muaji në muaj, si pasojë e ndryshimeve në koston e blerjes së energjisë në tregun e lirë për furnizimin e klientëve që marrin shërbimin në kushtet e mundësisë së fundit. Në këtë çmim, kostot e rrjetit dhe kostot administrative mbeten të pandryshuara, ndërsa komponenti kryesor që ndikon në luhatjen është kosto e energjisë së blerë.

Për muajin shtator 2025, kosto mesatare e blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës së klientëve të FMF-së ka rezultuar në vlerën 10.97 lekë/kWh, me një sasi të nominuar në bursën e energjisë prej 130.97 MWh. Ndërkohë, për muajin gusht 2025, kosto përkatëse ka rezultuar 10.92 lekë/kWh, me një sasi të nominuar prej 172.22 MWh. Në terma krahasues, kosto e blerjes së energjisë për muajin shtator është rritur rreth 0.5% në raport me muajin gusht, ndërsa sasia e energjisë së prokuruar për furnizimin e klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 35kV është ulur rreth 24%.

Për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit, çmimi i shitjes së energjisë elektrike mbetet i pandryshuar në nivelin 18.26 lekë/kWh, siç është miratuar nga ERE në fillim të vitit 2025. Ky çmim mbetet fiks, pasi energjia për këtë kategori sigurohet nga KESH sh.a. me një kosto të qëndrueshme furnizimi. Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe për të garantuar transparencë ndaj palëve të interesuara, ERE miraton dhe publikon periodikisht çmimin e llogaritur të shitjes së energjisë elektrike nga FMF, në zbatim të legjislacionit në fuqi.